

Programi IPA 2013 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë



Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën

(EuropeAid/135700/DH/SER/AL)

Draft 3

Ligji mbi Krimin ne Mjedis

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian





Titulli i Projektit:	Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën
Akronimi i Projektit:	IBECA
Numri i Projektit:	Europe Aid/135700/DH/SER/AL
Data e fillimit të projektit:	22 qershor 2015
Kohëzgjatja e projektit:	36 muaj
Autoriteti Kontraktues:	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ABA Business Centre Rruga Papa Gjon Pali II, Tirana, Albania. Z. Kai NAGEL, Menaxher Sektori, Mjedisi & Energjia Tel: +355 4 222 8320, Fax: +355 4 223 0752 e-mail: Kai.NAGEL@eeas.europa.eu
Përfituesi:	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Rruga "Norbert Jokl", ish ATSH, Tiranë, Shqipëri. Evisi Kopliku Drejtor, Drejtoria e Integritimit, Koordinimit, Marreveshjeve dhe Asistences Mob: +355694397595 e-mail: Evisi.Kopliku@turizmi.gov.al
Kontraktori:	Agrotec SpA Lungotevere Michelangelo, 9 - 00192 Roma, Italia Kastriot Koshaj Menaxher Projekti Tel: +39 063609381, Fax: +39 0636093861 e-mail: info@agrotec-spa.net
Titulli i Dokumentit:	Draft 3 i Ligjit mbi Krimin ne Mjedis

Shënim:

Ky raport është përgatitur nga një ekip i projektit që punon për Agrotec. Gjetjet, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm të Agrotec dhe nuk duhet të konsiderohen në asnjë mënyrë sikur reflektojnë opinionet dhe politikat e Komisionit Evropian.

Autorët e Draft Ligjit:

Prof.Ass.Dr.MSc. Narin PANARITI – Zevendes Drejtuese e Projektit – narin_panariti@yahoo.co.uk
LLM. Ilir BICJA – Ekspert Ligjor – ilirbicja@gmail.com

Data e Draft Ligjit: 20 Qershor 2018



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

**Projektligj¹
Nr. ...datë2017**

Drafti 3 – versioni 1
31.05.2018

**“PËR
DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.01.1995
"KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Në zbatim të nenit 81, paragrafi 2, shkronja “d” dhe nenit 83, paragrafi 1 të Kushtetutës me propozim të Këshillit të ministrave,

**KUVENDI
I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”, nenet 201, 202 dhe 203 ndryshohen si më poshtë:

¹Ky projektligj ka transpozuar PLOTËSISHT Direktivën 2008/99/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 19.11.2008 mbi mbrojtjen e mjedisit përmes të Drejtës Penale.

Neni 201

Çlirimi, shkarkimi, futja e materialeve ose rrezatimit jonizues në mjedis

Çlirimi, shkarkimi, futja e një sasive materialeve ose rrezatimi jonizues në ajër, tokë apo ujë, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo lejes së mjedisit, dhe që ka gjasa të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë ose që ka gjasa të shkaktojë dëmtime të rënda në shëndet ose vdekje, dënohet me gjobë ose me burgim nga 1 deri në 4 vjet;

Kur vepra e referuar në paragrafin 1 shkakton dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë dënohet me gjobë ose me burgim nga 2 deri në 5 vjet;

Kur vepra në paragrafin 1 shkakton dëmtim të rëndë në shëndet ose vdekje, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet.

Kur vepra në paragrafin 1 kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 201/a

Menaxhimi i mbetjeve

Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin ndaj vendeve të asgjësimit dhe veprimet e ndërmarra nga tregtari ose agjenti i mbetjeve, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo lejes së mjedisit, dhe që ka gjasa të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë apo ka gjasa të shkaktojë dëmtime të rënda në shëndet ose vdekje, dënohet me gjobë ose me burgim nga 1 deri në 4 vjet.

Kur vepra në paragrafin 1 shkakton dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës, cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë dënohet me gjobë ose me burgim nga 2 deri në 5 vjet.

Kur vepra në paragrafin 1 shkakton dëmtim të rëndë në shëndet apo vdekje dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet.

Kur vepra në paragrafin 1 kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 201/b

Transportimi i mbetjeve

Transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i RSH, në sasi jo-të papërfillshme, të kryera në një dërgesë të vetme apo në disa dërgesa në dukje të lidhura me njëra-tjetrën, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës ose të autorizimit për eksport apo kalim tranzit, dënohen me gjobë ose burgim nga 2 deri në 5 vjet.

Neni 201/c

Aktivitetet e rrezikshme

Funksionimi i një impianti ku zhvillohet një aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës ose lejes së mjedisit, dhe që ka gjasa të shkaktojë dëme të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit,

në kafshë apo në bimë, apo që ka gjasa të shkaktojë dëmtime të rënda në shëndet apo vdekje, dënohet me gjobë ose me burgim nga 1 deri në 5 vjet.

Kur vepra e referuar në paragrafin 1 shkakton dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës apo cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë dënohet me gjobë ose me burgim nga 2 deri në 8 vjet.

Kur vepra e referuar në paragrafin 1 shkakton dëmtim të rëndë në shëndet apo vdekje, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet.

Kur vepra e referuar në paragrafin 1 kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 vjet.

Neni 201/d

Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme

Prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës ose lejes/autorizimit përkatës, dhe që ka gjasa të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, apo që ka gjasa të shkaktojë dëmtime të rënda në shëndet ose vdekje, dënohet me gjobë ose me burgim nga 1 deri në 5 vjet.

Kur vepra e referuar në paragrafin 1 shkakton dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë dënohet me gjobë ose me burgim nga 2 deri në 5 vjet.

Kur vepra e referuar në paragrafin 1 shkakton dëmtim të rëndë në shëndet ose vdekje, dënohet me burgim nga 15 deri në 20 vjet.

Kur vepra e referuar në paragrafin 1 kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim nga 1 deri në 4 vjet.

Neni 202

Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër

Vrasja, shkatërrimi, zotërimi, marrja ose tregtimi i egzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nën-produkteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo lejes përkatëse, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre egzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim nga 2 deri në 7 vjet.

Neni 202/a

Habitatet në zonat e mbrojtura

Cdo vepër që shkel kërkesat e legjislacionit përkatës apo autorizimit përkatës dhe që shkakton përkeqësim të rëndë të një habitati që ndodhet brenda një zone të mbrojtur dënohet me gjobë ose me burgim nga 2 deri në 5 vjet.

Neni 203

Substancat ozon-holluese

Prodhimi, importimi, eksportimi, nxjerrja në treg ose përdorimi i substancave ozon-holluese duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo autorizimit përkatës, dënohet me gjobë ose me burgim nga 3 deri në 7 vjet.

Neni 2

Në nenin 282,

Titulli i nenit ndryshon si vijon: “Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse dhe djegëse”

Fjalët “ose substanca radioaktive” në paragrafin e parë shfuqizohen.

Shenja e pikësimit ‘,’ pas fjalës “lëndë plasëse” në paragrafin e parë ndryshohet në “ose”.

Neni 3

Në nenin 282/a,

Titulli i nenit ndryshon si vijon: “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese”

Fjalët “dhe substanca radioaktive” në paragrafin e parë shfuqizohen.

Shenja e pikësimit ‘,’ pas fjalës “i djegshëm” në paragrafin e parë ndryshohet në “ose”.